



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 58, Datë 08/05/2019

Mbështetur në shkresën nr. 1268 Prot, datë 18.09.2018, e Qendres Europiane për të Drejtat e Romëve¹, ku jepet informacion mbi disa situata dhe problematika, që lidhen me segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në qytetin e Shkodrës dhe specifikisht në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në referencë të gjermës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, filloi menjëherë procedurat administrative për shqyrtimin e çështjes ex-officio.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas informacionit të besueshëm.

Referuar informacionit të përcjellë nga ERRC, rezulton se pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, e cila ndodhet pranë vendbanimit të hershëm të familjeve egjiptiane në hyrje të qytetit të Shkodrës, ndjekin mësimin kryesisht nxënës romë dhe egjiptianë, që banojnë në lagjen “Liria” dhe lagjen “Përtej Bunës”. Shkolla 9-vjeçare “Liria” ka në administrim edhe shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem. Ndërkohë që, një pjesë e nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Liria” zhvillojnë mësim pranë Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Kapucinë”, pranë Fshatit të Pages.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën ERRC;

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD;

Aktualisht në këto 3 (tre) institucione mësojnë 130 nxënës të zonës përreth. Sipas informacionit të dërguar ERRC rezulton se, në ndërtesën kryesore të Shkollës “Liria” mësojnë vetëm 51 nxënës, ndërkohë që pjesa tjetër e nxënësve mëson pranë dy ndërtesave të tjera. Në shkollën “Isuf Tabaku”, Ajasem, ndjekin mësimin fillor 37 nxënës, ndër të cilët 15 janë romë dhe egjiptianë dhe 22 të tjerë janë jo rom. Sipas informacionit në fjalë, kjo shkollë ka një ndërtesë 2-katëshe, me një kapacitet prej 24 klasash, por numri i nxënësve që e frekuentojnë është shumë i ulët. Fëmijët romë dhe egjiptianë janë regjistruar në këtë shkollë, gjatë këtij viti shkollor. Pjesa më e madhe e nxënësve të klasave I-V, rreth 40 të tillë, mësojnë në ambientet e Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapucinë” pranë Fshatit të Paqes.

Çështjet e ngritura nga ERRC konsistojnë në faktin se Shkolla 9-vjeçare “Liria” është një shkollë e segreguar kryesisht me nxënës nga minoriteti egjiptian dhe ai rom dhe vetëm me një numër të kufizuar nxënësish jo romë/egjiptianë. Sipas informacionit të dërguar rezulton se fëmijët romë dhe egjiptianë të kësaj shkolle janë të përjashtuar nga mësimi i integruar, gjë që e bën të vështirë integrimin e tyre në shoqëri. ERRC thekson faktin se institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masat e mjaftueshme, për të luftuar diskriminimin nëpër institucionet mësimore. Këto institucione janë në dijeni të kësaj situatë mbipërfaqësimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe në shkollat anekse të saj. Kjo shkollë, e cila funksionon që prej vitit 2007, pavarësisht qëllimit si një shkollë e ngritur afër komunitetit, me qëllim rritjen e frekuentimit të procesit mësimor nga nxënësit rom dhe egjiptianë, ka ndihmuar në përfundim të segregimit. ERRC shprehet se institucionet përgjegjëse në Shkodër nuk kanë ndërgjegjësimin e duhur mbi pasojat afatgjata të segregimit, që është duke ndodhur pranë kësaj shkolle.

Në vijim, ERRC e bën me dije KMD-në se sipas shkresës nr. 185/1, datë 01.02.2018, të DAR Shkodër, drejtuar kësaj shoqate, citohet se ky institucion nuk e konsideron përqendrimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në Shkollën 9- vjeçare “Liria”, situatë segregimi, pasi regjistrimi i tyre në këtë shkollë është bërë në përputhje të plotë të kriterëve bazë, ku është respektuar për zgjedhja e shkollës nga vetë prindërit e fëmijëve, të cilët kanë qenë të hapur për t’i regjistruar fëmijët e tyre.

Në përgjigjen e DAR Shkodër përmendet fakti se për nxënësit që janë vendosur të zhvillojnë mësimin në ambientet e Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapucinë” pranë Fshatit të Paqes, kjo situatë është e përkohëshme, për shkak të mungesës momentale të mjediseve të mjaftueshme të Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Një gjë e tillë është bërë me qëllimin e mirë për të rritur frekuentimin e shkollës nga ana e tyre, meqënëse përveç ambienteve për mësim, ka patur edhe mbështetje me ushqim, veshje dhe mësues vullnetarë të jashtëm. Ndërkohë që, ERRC shprehet se godina e Shkollës “Isuf Tabaku”, Ajasem, është në gjendje infrastrukturore të mirë dhe më kapacitete të mjaftueshme për të akomoduar më shumë se 130 nxënës, që është numri

total i nxënësve, që marrin mësim në të tre godinat e Shkollës 9- vjeçare “Liria”. Stafi pedagogjik i shkollës është i përbërë nga 5 mësues dhe në të mësojnë 37 nxënës, 15 romë dhe 22 jo romë/egjiptianë.

Ndër të tjera, ERRC thekson faktin se shkollimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në ambientet e Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapucinë” pranë Fshatit të Paqes konsiderohet nga DAR Shkodër si përjasje e mirë, për faktin se shoqërohet me ushqim, veshje etj., por kjo shoqatë thekson faktin se duke vlerësuar pasojat segreguese rezultojnë të jetë qasja jo e duhur. Kjo shoqatë shprehet se institucionet përgjegjëse duhet të krijojnë mundësinë, që këto shërbime t’ua ofrojnë nxënësve romë dhe egjiptianë që mësojnë në 2 godinat e tjera të Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Në këtë kuadër, ERRC sjell nën vëmendjen e KMD-së nismën e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me pilotimin e projektit “*Të bëjmë detyrat në shkollë*”, nismë, e cila ka filluar të pilotohet në 5 (pesë) qarqe të vendit (Tiranë, Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Fier).

Ndër të tjera kjo nismë planifikon edhe krijimin e mensave dhe ofrimin e ushqimit për nxënësit në shkollë, proces ky që pritet të menaxhohet nga bashkitë përkatëse, të cilat do të mbulojnë nga fondet publike të tyre, gjysmën e kostos së ushqimit, ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga prindërit. Duke vlerësuar këtë mundësi, ERRC shprehet se Bashkia Shkodër mund të aplikojë dhe të bëjë të mundur që kjo nismë të zbatohet edhe në qarkun e Shkodrës, ku të përfshihet edhe Shkolla 9-vjeçare “Liria”. Ofrimi i shërbimeve të kësaj natyre është arsyeja, përse prindërit romë preferojnë t’i dërgojnë fëmijët e tyre pranë Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapucinë”, pranë Fshatit të Paqes.

ERRC vë në dukje të Komisionerit edhe çështjen e performancës së Shkollës 9-vjeçare “Liria”, e cila sipas informacionit të përcjellë nga kjo shoqatë renditet në vendin e 75, nga 77 shkolla të Shkodrës. Kjo, sipas ERRC-së ka ardhur si pasojë e segregimit të nxënësve romë dhe egjiptianë që mësojnë në godinat e kësaj shkolle. Tregues të qartë të cilësisë së ulët janë numri i ulët i nxënësve që frekuentojnë shkollën rregullisht dhe cilësia e përgatitja e nxënësve të kësaj shkolle. Përqindja e nxënësve që mësojnë në ambientet e Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapucinë”, pranë Fshatit të Paqes, të cilët vijnë më tej studimet në klasat VI-IX në shkollën 9-vjeçare “Liria” (ndërtesën kryesore) është shumë e ulët. ERRC shprehet se nga bisedat me prindër e aktivistë rezultojnë se vetëm një përqindje e vogël e nxënësve të Fshatit të Paqes, vijnë studimet në klasat më të larta, pasi e braktisin shkollën pasi përfundojnë klasën e pestë. Nga të dhënat e marra rezultojnë se vetëm 9 nxënës romë/egjiptianë nga Shkolla “Liria” kanë vijuar arsimin e mesëm.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga ERRC ka të bëjë edhe me sistemimin nëpër shkolla të fëmijëve romë të ardhur nga qytete të tjera. Rasti i paraqitur nga kjo shoqatë konsiston në sistemimin e 69 fëmijëve romë/egjiptianë në fillim vitin shkollor 2017-2018, 40 prej të cilëve të mbështetur në materialet didaktike dhe suportin e nevojshëm për të kryer procedurat e regjistrimit në shkollë nga stafi i organizatës ARSIS, do të regjistroheshin në njërin nga shkollat afër zones, ku fëmijët banonin. Këta fëmijë vinin kryesisht nga dy vendbanime informale të familjeve me të ardhura nga qytete të tjera. Pranë këtyre vendbanimeve ndodhen 2 shkolla 9-vjeçare, përkatësisht Shkollat 9-vjeçare “Salo Halili” dhe “Ndre Mjeda”. 40 fëmijët romë u regjistruan pranë Shkollës 9-vjeçare “Salo Halili”, me justifikimin e krijimit të një klase mbështetëse pas orarit mësimor. Kjo klasë mbështetëse asistohet nga një mësues i mbështetur financiarisht nga projekti i ARSIS, që do të ndihmonte nxënësit romë dhe egjiptianë. ERRC shprehet se përqëndrimi i 40 fëmijëve në shkollën 9-vjeçare “Salo Halili” është veprim segregues, pasi një pjesë e tyre mund të sistemoheshin në shkollën 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, që ka të njëjtën largësi nga vendbanimi ku jetojnë këta nxënës, ku mund të caktoheshin mësues ndihmës nga DAR Shkodër. Për këtë çështje, Qendra për të Drejtat e Gruas Rome iu drejtua DAR Shkodër, me një kërkesë formale, ku iu kërkua që të sigurohej mësues ndihmës për nxënësit romë në shkollën 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, në mënyrë që të mos kishte përqëndrim të këtyre pranë shkollës 9-vjeçare “Salo Halili”.

Sipas ERRC-së, kërkesa e shoqatës së sipërpërmendur u mbështet në *“Planin Kombëtar për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në RSH”*³. Kjo Qendër ngriti shqetësimin e saj edhe për 29 nxënësit e tjerë romë, të cilët tashmë ishin në moshë më të rritur për t’u regjistruar në klasë të parë, për të cilët DAR Shkodër propozoi në një takim me organizatat rome, krijimin e një klase të *“shansit të dytë”* pranë Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem, pa marrë parasysh mbipërfaqësimin e nxënësve romë pranë kësaj shkolle. Gjatë vitit shkollor 2016 – 2017, nga 140 nxënës që mësonin pranë kësaj shkolle, 107 ishin romë dhe 33 nxënës ishin jo romë, ndërsa gjatë vitit shkollor 2017-2018, numri i nxënësve jo romë u ul në 22. ERRC shprehet se DAR Shkodër nuk i ka kthyer përgjigje kësaj kërkesë të Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome.

Për sa më sipër, ERRC informon se ka ndjekur zhvillimet, lidhur me krijimin e klasës së *“shansit të dytë”*, për të cilën në vijim janë informuar, se do të krijohet pranë Shkollës 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, por që përfundimisht, as kjo nismë nuk u realizua, pasi nxënësit romë jetonin në vendbanime të ndryshme dhe larg kësaj shkolle. Ndërkohë që, as DAR Shkodër dhe as

³ Një ndër qëllimet strategjike të Planit Kombëtar për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në RSH, 2016-2020” është: *“Romët dhe egjiptianët kanë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit”*. Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, ky plan parashikon në pikën 1.4 të tij: *“Krijimin e pozicioneve ndihmëse për romët dhe egjiptianët në arsimin parashkollor dhe atë bazë (për ndihmë me detyrat e shtëpisë dhe studimin në klasat e ulëta 1-4)”*.

organizata të tjera, rrome nuk mundën të siguronin shërbimin e transportit falas për 29 nxënësit romë. Lidhur me këtë çështje, ERRC pretendon se përfaqësues të DAR Shkodër janë shprehur se nuk mund të sigurohej transporti falas, pasi vendbanimet e fëmijëve nga shkolla kishin largësi më pak se 2 km. Në këtë kontekst, ERRC thekson se në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve parashikohet qëllimi strategjik: *“Arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.”* Në pikën 1.11, të këtij qëllimi strategjik përcaktohet: *“Sigurimi i transporti falas për në shkollë dhe kopështe i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkollat/kopshtet larg (edhe nën 2 km) për arsye sigurie të justifikuar.”*

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit dhe verifikimit paraprak të informacionit të depozituar nga ERRC, u konstatua se nga pikëpamja formale, ky informacion plotësonte kriterin e të qënurit i besueshëm, mbi bazën e së cilit, KMD mund të fillonte kryesisht procedurat për shqyrtim, sipas parashikimit të gërmës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Në këto kushte, nëpërmjet Urdhërit nr. 184, datë 26.09.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat për shqyrtimin e saj kryesisht.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Shkodër, Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe për dijeni ERRC-së, me shkresën nr. 1329/1, datë 02.10.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga në informacionin e dërguar nga ERRC, si më poshtë vijojnë:
 - Numri i nxënësve romë që kanë mësuar përgjatë vitit shkollor 2017-2018 dhe mësojnë aktualisht përgjatë vitit shkollor 2018 – 2019, pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria, Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem dhe Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapuçinë” pranë Fshatit të Paqes;
 - Numri i nxënësve egjiptianë, që kanë mësuar përgjatë vitit shkollor 2017-2018 dhe mësojnë aktualisht përgjatë vitit shkollor 2018 – 2019, pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria, Shkollës

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

- “Isuf Tabaku”, në Ajasem dhe Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapuçinë” pranë Fshatit të Paqes;
- Numri i nxënësve jo romë/egjiptianë që kanë mësuar përgjatë vitit shkollor 2017-2018 dhe mësojnë aktualisht përgjatë vitit shkollor 2018 – 2019, pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria, Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem dhe Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapuçinë” pranë Fshatit të Paqes;
 - Numri i përafërt i popullsisë rome, egjiptiane dhe jo rome/egjiptiane në zonat e qytetit të Shkodrës, që mbulon Shkolla 9-vjeçare “Liria” dhe 2 shkollat anekse të saj;
 - Numri i stafit mësimor që jep mësim pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër, si dhe në 2 shkollat anekse të saj;
 - Informacion mbi gjendjen infrastrukturore të Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem, ku të përfshihen të dhëna mbi numrin e klasave, gjendjen e godinës etj.;
 - Mënyra se si po implementohet Plani Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, e parë kjo në kontekstin e dy çështjeve të cituara nga ERRC, lidhur me transportin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, vendbanimi i të cilëve është më pak se 2 km larg nga institucioni arsimor, si dhe çështja e caktimit të mësuesve ndihmës për mbarëvajtjen në shkollë të tyre;
 - Informacion, lidhur me përfshirjen e mundëshme të qarkut të Shkodrës, në nismën e ndërmarrë nga MASR, mbi implementimin e projektit “*Të bëjmë detyrat në shkollë*”, ku janë përfshirë 5 qarqe të vendit;
 - Informacion mbi numrin e klasave/niveleve, që përfshin mësimdhënia pranë Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem dhe Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapuçinë” pranë Fshatit të Paqes;
 - Numri i nxënësve, që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, që kanë mësuar pranë Shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasem dhe Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Minorë Kapuçinë” pranë Fshatit të Paqes, të cilët pas përfundimit të klasave/niveleve përkatëse pranë këtyre shkollave, përgjatë viteve shkollore 2016-2017 dhe 2017-2018, kanë vazhduar të ndjekin klasat në vijim pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër;
 - Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që kanë përfunduar Shkollën 9-vjeçare “Liria”, Shkodër dhe që kanë vazhduar arsimin e mesëm. Informacioni të jepet për tre vitet e fundit shkollorë.
1. Zarfi me shkresën nr. 1329/1, datë 02.10.2018 e KMD-së, drejtuar Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër u kthye mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin “*adresë e panjohur*”.
 2. Në përgjigje të shkresës nr. 1329/1, datë 02.10.2018, së Komisionerit, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 16203, datë 16.10.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin

se përgjatë vitit 2017-2018, Shkollën 9-vjeçare “Liria” e kanë frekuentuar rreth 131 nxënës, të cilët marrin mësim nga 13 mësues, ndërsa në shkollën “Isuf Tabaku”, në Ajasëm kanë mësuar përgjatë të njëjtit vit shkollor 37 nxënës, të cilëve u është dhënë mësim nga 5 mësues.

Lidhur me gjendjen infrastrukturore të shkollës “Isuf Tabaku”, në Ajasëm, Bashkia Shkodër informon se në këtë shkollë zhvillohet mësim për nxënësit që i përkasin arsimet parashkollor dhe arsimet bazë. Nga ana infrastrukturore, kjo shkollë është një godinë 2-katëshe me sipërfaqe 377 metër katrorë/kati. Në secilin kat zhvillohet mësim në katër klasa dhe mësimi zhvillohet në katër klasa të përbashkëta, për shkak të mungesës së fëmijëve. Në godinën e shkollës ka edhe ambiente ndihmëse. Infrastruktura e kësaj shkolle është e mirë, por është e nevojshme riparimi i disa aksesoreve në nyjet hidro-sanitare. Për vitin mësimor 2017-2018, sipas të dhënave të DAR Shkodër, në Shkollën “Isuf Tabaku” kanë zhvilluar mësim 8 klasa (I, II, III, V, VI, VII, VIII, IX). Shkolla bën pjesë në nivelin e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë.

Mbështetur në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të 4 (katër) Ministrive Nr. 1613, datë 04.09.2013, “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”, Marrëveshjen 3-ministore Nr. 3440, datë 12.06.2015 “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, si dhe takimeve të përbashkëta me përfaqësues të organizatave partnere dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale, me qëllim bashkërendimin e punës për edukimin e fëmijëve që rrezikojnë braktisjen e shkollës, ku më të rrezikuar janë fëmijët e komunitetit rom, Bashkia Shkodër informon se nga ky institucion janë marrë masa dhe janë identifikuar 107 fëmijë romë, të cilët në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale janë regjistruar në shkolla të ndryshme të qytetit. Për të shmangur çdo formë segregimi të fëmijëve romë dhe egjiptianë, që mbështeten për edukim nga Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, është realizuar shpërndarja e tyre në shkolla të ndryshme, si më poshtë:

- Në shkollën 9-vjeçare “Sapo Halili” janë regjistruar 43 fëmijë;
- Në shkollën 9-vjeçare “Ndre Mjeda” janë regjistruar 17 fëmijë;
- Në shkollën 9-vjeçare “Martin Camaj” janë regjistruar 10 fëmijë;
- Në shkollën 9-vjeçare “Ndoc Mazi” janë regjistruar 14 fëmijë;
- Në shkollën 9-vjeçare “Isuf Tabaku” janë regjistruar 20 fëmijë;
- Në shkollën 9-vjeçare “Ruzhdi Daca” janë regjistruar 3 fëmijë.

Në bashkëpunim me organizatat partnere është siguruar mbështetje me materiale shkollore si: çanta, mjete didaktike, pako me veshmbathje, transport dhe klasa pas shkollore, me qëllim plotësimin e nevojave për ecurinë e procesit edukativ të këtyre fëmijëve.

Gjithashtu, fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian në moshë për kopësht, janë regjistruar në 4 kopështe të ndryshme të qytetit, përkatësisht: në kopështin e Shkollës 9-vjeçare “Isuf Tabaku” janë regjistruar 20 fëmijë, në kopështin “Guerrile” janë regjistruar 15 fëmijë dhe në kopështin “Xhavit Jukni” janë regjistruar 10 fëmijë. Aktualisht, Bashkia Shkodër po monitoron çdo ditë frekuentimin e një arsimimi cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe jo diskriminuese për fëmijët romë dhe egjiptianë.

Për të siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të integruar të shërbimeve për këtë komunitet, Bashkia Shkodër me mbështetjen e PNUD-it dhe në kuadër të Projektit ESSERE, financuar nga Bashkimi Europian, ka vënë në funksionim Qendrën Komunitare Multifunksionale, e cila ofron shërbime të integruara sociale për fëmijët romë dhe egjiptianë, si dhe për familjet e maxhorancës, që banojnë në zonën, ku ndodhet kjo qendër.

3. Në përgjigje të shkresës nr. 1329/1, datë 02.10.2018, së Komisionerit, Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) Shkodër dërgoi shkresën nr. 1494, datë 26.10.2018⁵, nëpërmjet së cilës informon se numri i nxënësve romë dhe egjiptianë, për vitin shkollor 2017-2018, që mësojnë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, përfshirë këtu edhe nxënësit që mësojnë në ambientet e Kuvendit Fretërit Kapuçinë është 45 nxënës romë dhe 86 nxënës egjiptianë dhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, është përkatësisht 9 nxënës romë dhe 0 nxënës egjiptianë.

Për vitin shkollor 2018-2019, numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që mësojnë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, që përfshin edhe nxënësit që mësojnë në ambientet e Kuvendit Fretërit Kapuçinë është 42 nxënës romë dhe 87 nxënës egjiptianë dhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, është përkatësisht 22 nxënës romë dhe 0 nxënës egjiptianë.

Për vitet shkollorë 2017- 2018 dhe 2018-2019, numri i nxënësve të maxhorancës që mësojnë në shkollën “Liria”, që përfshin edhe nxënësit që mësojnë në ambientet e Kuvendit Fretërit Kapuçinë është 0 nxënës (për të dy vitet shkollorë) dhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, është përkatësisht 27 nxënës (2017-2018) dhe 19 nxënës (2018-2019).

⁵ Ky është numri i protokollit dhe data e regjistrimit të shkresës nr.2404/1, datë 15.10.2018, së DAR Shkodër, pranë Zyrës së KMD-së.

Lidhur me përcaktimin e numrit të përafërt të popullsisë rome, egjiptiane dhe jo rome/egjiptiane në zonat e qytetit të Shkodrës, që mbulon Shkolla 9-vjeçare “Liria” dhe 2 shkollat anekse të saj, DAR Shkodër sqaron se nuk ka informacion.

Lidhur me çështjen e pestë, për të cilën kërkohet informacion nga KMD, DAR Shkodër informon se numri i stafit mësimor pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” është 13 mësues, ndërsa në Shkollën “Isuf Tabaku” japin mësim 5 mësues. Numri total i stafit mësimor është 19, ku përfshihet edhe drejtori i shkollës. Ndërkohë që, në këto dy shkolla punon edhe një psikolog.

DAR Shkodër informon se infrastruktura e Shkollës 9-vjeçare “Liria” është e mirë, por ambientet nuk janë të mjaftueshme për numrin e plotë të klasave, që ka kjo shkollë. Për këtë arsye, klasa e katërt me 13 nxënës, e zhvillon mësimin në ambientet e Fshatit të Paqes.

Gjendja e godinës së shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem është relativisht e mirë, por ka nevojë për rikontruksion. Kjo godinë ka kapacitet në 10 klasa.

DAR Shkodër e bën me dije KMD-në, se në bashkëpunim të ngushtë me NJQV, drejtoritë e institucioneve shkollore, organizata të ndryshme dhe me komunitetin, duke hartuar plane të veçanta veprimi, ka bërë të mundur implementimin e Planit Kombëtar të Integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, në nivel lokal, duke realizuar regjistrimin e të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm. DAR Shkodër në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, në këtë vit shkollor ka bërë të mundur regjistrimin në shkollë të 126 nxënësve në situatë rruge në 12 shkolla, përkatësisht në:

- 1 nxënës pranë Shkollës së Mesme të Bashkuar “Adem Haxhia”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 24 nxënës pranë shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem;
- 1 nxënës pranë shkollës vartëse “Domen”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 2 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Dragoç”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 9 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Edit Durham” Shkodër;
- 8 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Isa Jakupi”, Dobrac, Njësia Administrative Rrethina;
- 18 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Martin Camaj”, Bashkia Shkodër;
- 17 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ndoc Mazi”, Shkodër;
- 1 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, Shkodër;
- 3 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ruzhdi Daca”, Shkodër;
- 41 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Salo Halili”, Shkodër;
- 1 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “3 Dhjetori”, Shkodër.

Në shkresën nr. 1494, datë 26.10.2018, e DAR Shkodër theksohet fakti se shpërndarja e mësipërme është kryer në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit nr. 17, datë 09.05.2018 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”, si dhe në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet MAS, MB, MPCSSHB, MSH, Nr. 1613, datë 04.09.2013, duke siguruar për nxënësit romë e egjiptianë mësim integrues dhe mësim mbështetës, nëpërmjet zbatimit të planeve individuale që vetë shkollat do të implementojnë për këta nxënës.

Krijimi i pozicioneve ndihmëse për nxënësit romë e egjiptianë në arsimin parashkollor dhe atë bazë (për ndihmë në detyrat e shtëpisë dhe studimin në klasat e ulëta I-V) është kryer në shkollat 9-vjeçare “Edit Durham” dhe “Dëshmorët e Prishtinës”, Shkodër. Ndërkohë që, organizimi i kurseve pas shkollës, ku prindërit romë dhe egjiptianë, me mungesë arsimit, ftohen dhe marrin pjesë të mësojnë dhe shkruajnë me fëmijët e tyre është realizuar pranë shkollës 9-vjeçare “Liria” e cila është Shkollë-Qendër Komunitare, që i shërben për të gjithë komunitetin të asaj lagjeje.

Në shkresën e DAR Shkodër përmendet gjithashtu ofrimi i teksteve mësimore falas për të gjithë nxënësit romë dhe egjiptianë, ndërkohë që theksohet fakti se sigurimi i transportit falas i fëmijëve romë dhe egjiptianë për në shkollë dhe kopështe, është bërë i mundur në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër në 4 (katër) shkolla të këtij qyteti.

DAR Shkodër përmend edhe faktin e aksesit në procesin e mësimdhënies të atyre prindërve romë e egjiptianë apo personave madhorë të këtij komuniteti, të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm. Këta persona aktualisht mësojnë pranë shkollës 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës” dhe në këtë vit mësimor janë regjistruar 19 nxënës.

Në shkresën e DAR Shkodër theksohet fakti se kjo drejtori po zbaton nismën “Të bëjmë detyrat e shtëpisë” në 5 (pesë) shkolla të këtij qyteti, njëra prej të cilave është edhe shkolla 9-vjeçare “Edit Durham”, në të cilën mësojnë nxënës të komunitetit rom. Përfitues të kësaj nisme janë 10 nxënës romë që mësojnë pranë kësaj shkolle. Ndërkohë, DAR Shkodër është në diskutim e sipër me komunitetin e prindërve romë e egjiptianë, Bashkinë Shkodër, si dhe organizata të ndryshme që veprojnë e mbështesin edukimin e fëmijëve romë e egjiptianë, për të bërë të mundur përfshirjen e Shkollës 9-vjeçare “Liria”, në projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, për të siguruar mësues mbështetës për këtë projekt.

Shkolla 9-vjeçare “Liria”, Shkodër ka 5 (pesë) klasa AF dhe 4 (katër) klasa AMU. Njëra prej klasave AF e zhvillon mësimin në ambientin e vënë në dispozicion nga Kuvendi i Etërve Kapuçinë në Fshatin e Paqes, për mungesë kapacitetesh. Shkolla vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem ka 2 klasa të bashkuara AF dhe 2 klasa të bashkuara AMU.

Njëkohësisht, DAR Shkodër sqaron se shkolla vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem është shkollë 9-vjeçare dhe nxënësit e kësaj shkolle përfundojnë ciklin e shkollimit 9-vjeçar. Ndërkohë që, klasa e vendosur në Fshatin e Paqes, ndjek mësimet në AMU, pranë Shkollës “Liria” dhe në vitin shkollor 2016-2017, kanë frekuentuar shkollën të gjithë nxënësit e regjistruar. E njëjta situatë konstatohet edhe për vitin shkollor 2017-2018.

Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë, që kanë përfunduar klasën e nëntë dhe kanë vazhduar arsimin e AML është si vijon:

- Për vitin shkollor 2015-2016, pranë shkollës 9-vjeçare “Liria” kanë përfunduar klasën e nëntë, 18 nxënës romë dhe egjiptianë dhe kanë vazhduar AML vetëm 10 nxënës romë. Pranë shkollës “Isuf Tabaku” asnjë nxënës nuk ka përfunduar klasën e nëntë dhe e njëjta situatë është edhe për AML;
- Për vitin shkollor 2016-2017, pranë shkollës 9-vjeçare “Liria” kanë përfunduar klasën e nëntë 15 nxënës romë dhe egjiptianë dhe kanë vazhduar AML 2 nxënës romë dhe 7 nxënës egjiptianë. Pranë shkollës “Isuf Tabaku” asnjë nxënës nuk ka përfunduar klasën e nëntë dhe e njëjta situatë është edhe për AML;
- Për vitin shkollor 2017-2018, pranë shkollës 9-vjeçare “Liria” kanë përfunduar klasën e nëntë 9 nxënës romë dhe egjiptianë dhe kanë vazhduar AML 1 nxënës romë dhe 4 nxënës egjiptianë. Pranë shkollës “Isuf Tabaku” asnjë nxënës nuk ka përfunduar klasën e nëntë dhe e njëjta situatë është edhe për AML.

Në shkresën e saj, DAR Shkodër thekson faktin se në përputhje me misionin e saj, ka patur në vëmendje të veçantë krijimin e mundësive të barabarta për edukim dhe shkollim të nxënësve të komunitetit romë dhe egjiptian. Në këtë aspekt, në shumë shkolla nën juridiksionin e DAR Shkodër është bërë e mundur regjistrimi i tyre për t’u arsimuar, si dhe janë marrë masa për mos segregimin e tyre. Nxënësit romë janë regjistruar në shkolla pranë vendbanimeve të tyre, sipas kërkesës së prindërve të tyre.

Shkolla 9-vjeçare “Liria” është e pozicionuar në qendër të lagjes “Liria”, një ndër më të vjetrat e qytetit të Shkodrës, ku kanë vendbanimin e tyre, të hershëm egjiptianët dhe romët e këtij qyteti, të cilët janë regjistruar në këtë shkollë, tradicionalisht që në hapjen e saj. DAR Shkodër ka patur një vëmendje të veçantë, lidhur me nevojat e kësaj shkolle mbi çështjet infrastrukturore, përfshirjen e saj në projekte të dobishme dhe gjithëpërfshirëse, në plotësimin me mësues të të gjitha profileve dhe të kualifikuar, si dhe duke siguruar gjithashtu edhe shërbimin psiko-social pranë kësaj shkolle.

Në zbatim të Dispozitave Normative “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (2013), DAR Shkodër ka kryer regjistrimin e nxënësve romë dhe egjiptianë, sikurse

edhe për nxënësit e tjerë që i përkasin maxhorancës, duke respektuar zonën, vendbanimin si dhe zgjedhjen e prindërve për të përzgjedhur shkollën më të afërt publike për regjistrimin e fëmijëve të tyre. DAR Shkodër ka qenë e hapur dhe ka respektuar zgjedhjen e prindërve, të cilët kanë qenë të lirë të bëjnë edhe zgjedhje të tjera, kur e kanë parë të arsyeshme. Në opinionin e prindërve të fëmijëve apo shoqatave të ndryshme, që përfaqësojnë interesat e komunitetit rom dhe egjiptian, është shprehur një vlerësim mjaft pozitiv për punën dhe përkushtimin ndaj këtij komuniteti, fakt që është bërë i qartë edhe nëpërmjet një deklarate të përbashkët.

Shkolla 9-vjeçare “Liria” është një shkollë që i shërben jo vetëm komunitetit rom dhe egjiptian, por edhe të gjithë banorëve të kësaj lagjeje. Nxënësit e ri-regjistruar në këtë shkollë janë nxënës që e kanë shkollën më të afërt me vendbanimin. Zgjedhja e shkollës për nxënësit është kryer me vullnetin e plotë të prindit. Kjo shkollë po i përmirëson treguesit vit pas viti.

3. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore mbi çështjen ex-officio, Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore në datën 18.12.2018, ora 12:00.

Në seancë dëgjimore morën pjesë përfaqësues të ERRC, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përfaqësues të DAR Shkodër dhe të Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Përfaqësuesja e ERRC-së në Shqipëri, Znj. M. V. parashtroi situatën e konstatuar nga ana e kësaj shoqate, mbi nxënësit romë dhe egjiptianë që mësonin në shkollën 9-vjeçare “Liria”, duke theksuar faktin se përqendrimi i tyre në këtë shkollë përbënte segregim, pasojat e të cilit do të ishin tepër negative në të ardhmen. Ajo u shpreh se institucionet përgjegjëse nuk e konsideronin segregim përqëndrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, sidomos në Fshatin e Paqes, për shkak të benefiteve, që ata në Kuvendin e Fretërve Kapuçinë. Shkolla 9-vjeçare “Liria” ka 5 klasa, ku mësojnë 51 nxënës romë dhe egjiptianë. Në shkollën vartëse në Ajasem, marrin mësim vetëm 2 klasa, ndërkohë që kapaciteti i shkollës është për 10 klasa. Përfaqësuesja e ERRC-së në Shqipëri kërkoi që të ndalohej situata segreguese, duke gjetur mbështetje edhe në Rekomandimet e mëparshme të Komisionerit, nëpërmjet së cilëve është kërkuar ndalimi i segregimit të nxënësve romë dhe egjiptianë në institucionet arsimore. Znj. M.V. theksoi faktin se materiali i ERRC-së drejtuar Komisionerit ka rreth 1 (një) vit që është përgatitur dhe është mbështetur në informacione të marra edhe gjatë disa takimeve konsultative të realizuara me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për këtë çështje.

Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Liria” fillimisht sqaroi se nxënësit, që vitin e kaluar arsimor kanë mësuar pranë Kuvendit të Fretërve Kapuçinë, aktualisht mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër. Ai theksoi faktin se Kuvendi i Fretërve Kapuçinë nuk është shkollë vartëse e Shkollës 9-vjeçare Liria, por disa nga ambientet e këtij Kuvendi pranë fshatit të Paqes janë

përdorur për nxënësit që banonin përtej Bunës, pasi përkohësisht ata nuk mund të vinin për mësim pranë Shkollës “Liria”, për shkak të infrastrukturës rrugore, që nuk ishte në gjendje të mirë. Por, aktualisht, ky problem konsiderohej i zgjidhur, pasi ata tashmë mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Ai theksoi faktin se Shkolla Vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, ndodhej rreth 2.5 km largësi nga shkolla 9-vjeçare “Liria”. I pyetur nëse pranë të dyja shkollave kishtë nxënës me përqendrim të nxënësve romë dhe egjiptianë, drejtori i shkollës u përgjigj se nuk ka klasa vetëm me nxënës romë, por ekziston vetëm një klasë vetëm me nxënës egjiptianë, por këta të fundit nuk dallohen nga maxhoranca. Ai u shpreh se qyteti i Shkodrës ka pak romë dhe shumica e tyre janë të ardhur nga qytetet të tjera. Në Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, mësojnë fëmijët e familjeve, që banojnë në lagjien “Liria” dhe në Ajasem. I pyetur nga Komisioneri, nëse prindërit e fëmijëve romë që mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, kanë pasur informacion mbi konceptin e segregimit dhe pasojat e tij, drejtuesi i shkollës u shpreh se ai vetë është njohur vonë me konceptin e segregimit, por ai ka realizuar një takim me prindërit e nxënësve romë dhe egjiptianë ku i ka informuar se kanë liri për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollën, që ata e konsiderojnë të përshtatshme.

Përfaqësuesi i DAR Shkodër sqaroi se shkolla të tjera të afërta me shkollën 9-vjeçare “Liria” janë shkollat 9- vjeçare “Ali Laçej” dhe “Ndre Mjeda”, Shkodër, distanca e të cilave me Lagjen Liria është mbi 2 km. Lidhur me sigurimin e transportit falas për fëmijët romë dhe egjiptianë, përfaqësuesi i DAR Shkodër sqaroi se në bazë të aktit përkatës nënligjor, ky transport sigurohej vetëm për rastet, kur largësia ndërmjet institucionit arsimor dhe vendbanimit të nxënësve ishte mbi 2 km. Kjo, sipas përfaqësuesit të DAR Shkodër, ishte paksa kontradiktore, për sa i përket faktin që në pikën 1.11., të Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, ku përcaktohet transporti falas për nxënësit që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Lidhur me çështjen e regjistrimit në shkolla të nxënësve të këtij komuniteti, ai sqaroi se i jepej prioritet vullnetit të prindit për të regjistruar fëmijën e tij, në atë shkollë që e konsideronte më të përshtatshme, fakt që gjen parashikim edhe në ligjin nr. 62/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar). Përfaqësuesi i DAR Shkodër theksoi faktin se në Shkollën 9-vjeçare “Liria” nuk ka situatë segregimi të nxënësve romë dhe egjiptianë dhe sqaron se në këtë shkollë ofrohet një arsim cilësor dhe kjo shkollë është gjithashtu një qendër komunitare. Tregues për nivelin e kësaj shkolle është karta e performancës, e cila evidenton faktin se kjo shkolle brenda 2 viteve të fundit ka kaluar nga vendi i 75, në vendin e 61, në qarkun e Shkodrës. Kjo demonstron rritje të nivelit të mësimdhënies dhe rezultateve përkatëse të nxënësve të kësaj shkollë. Njëkohësisht, përfaqësuesi i DAR Shkodër theksoi faktin se ky institucion e siguron transportin falas për të gjithë fëmijët, vendbanimi i së cilëve është më shumë se 2 km nga shkolla, ku mësojnë.

Përfaqësuesit e Bashkisë Shkodër u shprehën në seancë dëgjimore, se ky institucion ka siguruar ushqime, veshmbathje dhe transport falas për fëmijët romë dhe egjiptianë të Shkodrës. Bashkia Shkodër ka krijuar 10 Qendra Komunitare për familjen, në të cilat kanë akses dhe përfitojnë shërbime edhe familjet rome dhe egjiptiane, të cilat janë të përqëndruara më së shumti në 5 kampe rome në afërsi të lumenjve, si dhe pranë lagjies ‘Liria’. Në lagjien “Liria” ushtrojnë funksionet e tyre 2 (dy) Qendra Komunitare. Njëra prej tyre është e krijuar nga DAR Shkodër dhe ndodhet brenda Shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe tjetra është Qendra Komunitare për Familjen e ngritur nga Bashkia Shkodër, e cila frekuentohet nga familjet rome dhe egjiptiane, që banojnë në këtë lagjie. Lidhur me realizimin e transportit falas të fëmijëve romë dhe egjiptianë, përfaqësueset e Bashkisë Shkodër sqaruan se kjo realizohej falë bashkëpunimit me shoqata dhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit në seancë, lidhur me çështjen e sigurimit të transportit falas për fëmijët romë dhe egjiptianë, u theksua fakti se në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, parashikohet transporti falas për nxënësit, që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, edhe për largësitë nën 2 km, për arsye sigurie të justifikuar. Ndër të tjera, përfaqësueset e Bashkisë Shkodër theksuan faktin se të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë, që merrnin shërbime pranë Qendrave Komunitare për Familjen, mësonin në bazë të PEI-ve, të hartuar posaçërisht për ta.

Përfaqësueset e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) u shprehën se kuadri ligjor për marrjen e masave pozitive për nxënësit, që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian është tepër i mirë. MASR ka miratuar udhëzim për regjistrimin me përparësi të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopështe, si dhe për këtë vit arsimor ka dalë udhëzim i posaçëm mbi frekuentimin e shkollave nga nxënësit rome dhe egjiptianë, në shkolla të zakonshme. Njëkohësisht, janë vënë në funksionim programe të gjuhës rome që Qendrat Komunitare, si dhe janë nënshkruar marrëveshje 4 (katër) ministrore për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge dhe regjistrimin e tyre në shkollë. Përfaqësueset e MASR theksuan faktin se janë ndërmarrë politika të ndryshme nga shteti shqiptar për shpërndarjen e komunitetit rom në lagjien “Liria”, Shkodër, por pavarësisht kësaj familjet rome janë rikthyer sërish në këtë lagjie. Shkolla 9-vjeçare “Liria”, Shkodër ka një drejtues dhe staf të mirë mësimor dhe kjo shkollë është trajtuar njëllor me të njëjtin standard me shkollat e tjera në Shkodër. Për sa kohë që, lagjia “Liria” banohet me popullsi rome dhe egjiptiane, rrjedhimisht edhe shumica dërmuese e nxënësve që frekuentojnë Shkollën 9-vjeçare “Liria” do të jetë rome dhe egjiptiane.

Gjatë seancës dëgjimore Komisioneri kërkoi që në vijim, DAR Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Shkolla 9-vjeçare “Liria”, Shkodër, të dërgonin informacion të detajuar , në lidhje me disa çështje specifike, që diskutuan në këtë seancë.

- Në kushtet kur, informacioni i dërguar nga institucionet e sipërpërmendura kishte nevojë për të dhëna plotësuese, Komisioneri iu drejtua me shkresën nr. 317, datë 28.02.2019, DAR Shkodër, Bashkisë Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër, ku u kërkohej informacion mbi çështjet e mëposhtëme:
 - Informacion i detajuar mbi përbërjen e klasave të Shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku, Shkodër, duke evidentuar numrin e nxënësve romë, egjiptianë dhe nxënësve të maxhorancës, për secilën klasë. Ky informacion të dërgohet për 5 (pesë) vitet e fundit;
 - Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë, që pas përfundimit të arsimit 9-vjeçar pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” apo Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku”, Shkodër, kanë ndjekur dhe përfunduar arsimin e mesëm. Ky informacion të dërgohet për 5 (pesë) vitet e fundit;
 - Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë, që kanë ndjekur për 3 (tre) vitet e fundit arsimorë dhe ndjekin aktualisht arsimin 9-vjeçar pranë Shkollave 9-vjeçare “Ali Laçej” dhe “Ndre Mjeda”, Shkodër. Në informacion të evidentohet numri total i nxënësve për secilën shkollë, si dhe të reflektohet raporti i numrit të nxënësve të sipërpërmendur, me numrin e nxënësve të maxhorancës;
 - Informacion mbi takime periodike të realizuara gjatë këtij viti shkollor, me prindërit e nxënësve romë dhe egjiptianë, ku këta të fundit të jenë informuar mbi segregimin dhe pasojat e tij tek fëmijët e tyre. A janë informuar prindërit e fëmijëve romë dhe egjiptianë, të lagjes “Liria” mbi faktin se fëmijët e tyre mund të regjistrohen edhe në shkolla të tjera, pasi transporti për ta sigurohet falas nga DAR Shkodër?
 - Informacion mbi numrin e shkollave 9-vjeçare, në të cilat sigurohet transporti falas për fëmijët romë dhe egjiptianë.
 - Informacion mbi shkollat, ku janë regjistruar 27 fëmijët romë dhe egjiptianë, në kuadër të zbatimit të klasës “Shansi i Dytë”. Sa prej tyre ndjekin aktualisht shkollën dhe sa prej tyre e kanë braktisur?
 - Informacion se kur është kryer investimi i fundit për godinat e Shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku”, Shkodër. Cilat janë investimet që janë planifikuar të kryhen në të ardhmen në këto shkolla?
- 1. Në përgjigje të shkresës nr. 317, datë 28.02.2019, të Komisionerit, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 3955, datë 12.03.2019, nëpërmjet së cilës informon mbi numrin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, që përfitojnë transport falas dhe shërbime të tjera mbështetëse pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për familjen”, të Bashkisë Shkodër me mbështetjen e organizatave partnere, që bashkëpunojnë për përmirësimin e situatës social-ekonomike të

komunitetit rom dhe egjiptian. Sipas shkresës së sipërpërmendur rezulton se numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla 9-vjeçare, që përfitojnë transport falas është 66, ndërsa numri i tyre që përfitojnë transport falas për në kopësht është 26 të tillë.

Në lidhje me investimet e realizuara dhe ato të planifikuara në godinën e shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku”, Shkodër, rezulton se në vitin 2010 është realizuar konstruksioni i shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, në vlerën 7,949,927 lekë. Ndërkohë që, në shkresën e Bashkisë Shkodër theksohet fakti se Shkolla 9-vjeçare “Liria” është investim i viteve të fundit. Ndërtimi i kësaj shkolle është realizuar në vitin 2004.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 317, datë 28.02.2019, të Komisionerit⁶, DAR Shkodër dërgoi pranë Komisionerit, shkresën nr. 317/1, datë 21.03.2019⁷, ku bashkëlidhur saj, dërgohet informacioni i përcjellë nga ana e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Liria” pranë DAR Shkodër. Sipas informacionit të sipërpërmendur sqarohet se numri i nxënësve të komunitetit rom dhe egjiptian, që kanë përfunduar Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe kanë vazhduar AML⁸ nuk është i madh, pasi ka patur shumë largime jashtë shtetit. Rreth 18 nxënës, që i përkasin komuniteteve të mësipërme, të cilët 3 vitet e fundit kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar pranë kësaj shkolle, në vijim kanë vazhduar AML. Nga këta nxënës, 10 nxënës janë egjiptianë dhe 2 nxënës janë romë. Ndërkohë që, në Shkollën “Isuf Tabaku”, Ajasem, AML-në e kanë vazhduar të gjithë nxënësit, pasi nuk ka patur nxënës romë dhe egjiptianë në klasën IX⁹.

Bashkëlidhur shkresës nr. 317/1, datë 21.03.2019, të DAR Shkodër, janë përcjellë tabelat përkatëse, ku reflektohen të dhënat mbi numrin e nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, përgjatë viteve shkolllore 2014-2015, 2015-2016, 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018-2019, për klasat I-IX. Të dhënat mbi përbërjen komunitare të nxënësve në të dyja shkollat janë dërguar vetëm për vitin e fundit shkollor.

Njëkohësisht DAR Shkodër ka dërguar pranë KMD-së edhe shkresën nr. 606, e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Liria”, me lëndë “Raport mbi zhvillimin e takimeve me prindër në kuadër të ndërgjegjësimit komunitar mbi problematikën e segregimit në institucionet arsimore”¹⁰, shkresën e DAR Shkodër me lëndë: *Raporti progresiv i takimeve me prindër në kuadër të nismës së Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit mbi “Ditët e hapura me prindër”*, të zhvilluara në shkollat “Liria” dhe Isuf Tabaku” etj.

⁶ Afati i vendosur nga KMD, për dërgimin e informacionit nga ky institucion, është data 08.03.2019.

⁷ Shkresa mban numrin dhe datën e regjistrimit/mbërritjes pranë KMD-së.

⁸ Shkurtim - Arsim i Mesëm i Lartë.

⁹ Këtu nuk jepet referencë për vitin/et përkatëse, për të cilët jepet kjo statistikë.

¹⁰ Shkresa nuk e përmban datën e regjistrimit me numrin përkatës të protokollit.

3. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me situatën e segregimit të pretenduar nga ERRC.

Informacioni i dërguar nga ERRC përmban disa pretendime, që kjo shoqatë parashtron në lidhje me veçimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkollën 9-vjeçare “Liria”, Shkodër, si dhe mbi disa problematika të tjera, të cilësuara si segreguese ndaj fëmijëve romë dhe egjiptianë në Shkodër.

Referuar informacionit të përcjellë nga ERRC, sikurse edhe nga DAR Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Shkolla 9-vjeçare “Liria”, rezulton se kjo e fundit e ka vendndodhjen në Lagjen Liria, e cila ndodhet pranë vendbanimit të hershëm të familjeve egjiptiane në hyrje të qytetit të Shkodrës, pra në një lagje që popullohet nga familje egjiptiane të këtij qyteti, si dhe nga familje rome të ardhura nga qytete të tjera.

Në bazë të informacionit statistikor, të dërguar nga drejtuesi i Shkollës 9-vjeçare “Liria” rezulton si më poshtë vijon:

Tabela 1 - Informacion mbi numrin e nxënësve për çdo klasë, si dhe përbërjen komunitare të nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Liria”.

Përbërja komunitare e nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Liria”								
Klasat	Viti 2014- 2015	Viti 2015- 2016	Viti 2016- 2017	Viti ¹¹ 2017- 2018	Viti 2018- 2019	Egjiptianë 2018-2019	Romë 2018- 2019	Maxhorancë 2018-2019

¹¹ Për vitet shkollore paraardhës, Komisioneri nuk disponon informacion mbi raportin komunitar të nxënësve të kësaj shkolle;

I	22	12	14	18	23	12	8	3
II	22	14	13	15	13	7	3	2
III	20	11	16	15	17	13	2	2
IV	19	18	12	11	13	5	4	4
V	18	10	20	13	14	9	2	3
VI	21	13	10	16	10	4	4	2
VII	19	12	11	10	18	10	4	4
VIII	10	13	15	10	12	7	3	2
IX	6	6	18	15	10	6	2	2
Totali	157	109	129	123	130¹²	73	32	24

Tabela 2 - Informacion mbi numrin e nxënësve për çdo klasë, si dhe përbërjen komunitare të nxënësve të Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem.

Përbërja komunitare e nxënësve të Shkollës Vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem								
Klasat	Viti 2014-2015	Viti 2015-2016	Viti 2016-2017	Viti¹³ 2017-2018	Viti 2018-2019	Egjiptianë 2018-2019	Romë 2018-2019	Maxhorancë 2018-2019
I	2	8	8	7	7	0	7	-
II	5	-	3	11	7	0	3	4
III	6	5	-	2	9	0	8	1
IV	4	3	6	-	3	0	2	1
V	6	3	2	6	2	0	2	-
VI	2	4	3	2	5	0	-	5
VII	4	2	4	3	3	0	3	-
VIII	10	4	2	3	5	0	1	4
IX	5	10	5	3	3	0	-	3
Totali	44	39	33	37	44	0	26	18

¹²Nga mbledhja e të dhënave të 3 (tre) kolonave pasardhëse (nx. romë, egjiptianë dhe maxhorancë) rezulton që numri i nxënësve për vitin 2018-2019 është 129, jo 130. Gabimi në llogaritje i takon numrit total të nxënësve të klasës së II, për vitin shkollor 2018-2019, i cili është 12 jo 13 nxënës. Të dhënat në tabelë janë shënuar, sikurse janë referuar nga drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Liria”;

¹³ Për vitet shkollore paraardhës, Komisioneri nuk disponon informacion mbi raportin komunitar të nxënësve të kësaj shkolle;

Mbështetur në rezultatet e Tabelës 1, Komisioneri ka konstatuar mospërputhje të të dhënave të sipërpërmendura, mbi përbërjen komunitare të nxënësve në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, për vitet shkollorë 2017-2018 dhe 2018-2019, të dërguara nga DAR Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. 2404, datë 15.10.2018. Sipas informacionit të përcjellë nga DAR Shkodër rezultojnë se numri i nxënësve romë dhe egjiptianë, për vitin shkollor 2017-2018, që mësojnë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, përfshirë këtu edhe nxënësit që mësojnë në ambientet e Kuvendit Fretërit Kapuçinë, është 45 nxënës romë, 86 nxënës egjiptianë dhe 0 nxënës të maxhorancës (131 nxënës në total) dhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, është përkatësisht 9 nxënës romë, 0 nxënës egjiptianë dhe 27 nxënës të maxhorancës.

Për vitin shkollor 2018-2019, numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që mësojnë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, që përfshin edhe nxënësit që mësojnë në ambientet e Kuvendit Fretërit Kapuçinë është 42 nxënës romë, 87 nxënës egjiptianë dhe 0 nxënës të maxhorancës (129 nxënës në total) dhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem, është përkatësisht 22 nxënës romë dhe 0 nxënës egjiptianë dhe 19 nxënës të maxhorancës.

Mospërputhje në shifra për vitin shkollor 2018-2019 konstatohen edhe në përbërjen komunitare të nxënësve në Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, si edhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve për këtë vit shkollor.

Sikurse është përmendur edhe më sipër, në vijim DAR Shkodër ka dërguar nëpërmjet shkresës nr. 317/1, datë 21.03.2019, pranë KMD-së, të dhënat mbi përbërjen komunitare të nxënësve, të Shkollës 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, sipas informacionit tabelor, të nënshkruar nga Drejtori i Shkollës. Këto të dhëna janë të ndryshme krahasuar me të dhënat e dërguara me shkresën nr. 1494, datë 26.10.2018, të DAR Shkodër.¹⁴

Mbështetur në nenin 12, pika 5, Kreu IV, të Urdhërit Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”* (i ndryshuar) parashikohet: *“Në fund të periudhës së regjistrimit në shkollat publike, drejtorët e shkollave bazë publike dhe ato private i dërgojnë DAR/ZA-së listat emërore të fëmijëve të regjistruar në shkollat e tyre.”* Njëkohësisht në pikën 9, të të njëjtit nen parashikohet: *“Shkollat publike identifikojnë fëmijët, që i përkasin zonës së tyre dhe, deri në fund të muajit tetor të vitit të ri mësimor marrin përsipër regjistrimet e nxënësve dhe informojnë zyrtarisht DAR/ZA-në përkatëse.”*

Në këto kushte, rezultojnë se shkollat publike kanë detyrim të dërgojnë informacion pranë DAR/ZA, mbi nxënësit që regjistrohen për herë të parë, apo ata që mësojnë në vitet vijuese pranë

¹⁴ Shkresa nr. 2404/1, datë 15.10.2018, e DAR Shkodër (referuar numrit të protokollit të institucionit dërgues).

tyre. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se të dhënat e DAR Shkodër janë të bazuara në informacionin e dërguar nga drejtuesi i Shkollës 9-vjeçare “Liria. Mbështetur në sa më sipër, të dhënat që do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje ex-officio janë të dhënat e depozituara nga DAR Shkodër pranë KMD-së, nëpërmjet shkresës nr. 1494, datë 26.10.2018, së DAR Shkodër.

Sikurse vihet re më sipër, nga të dhënat e dërguara nga DAR Shkodër, me shkresën nr. 1494, datë 26.10.2018 (nr. 2404/1, datë 15.10.2018), rezulton se për vitet shkollorë 2017-2018 dhe 2018-2019, pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” mësojnë vetëm nxënës romë dhe egjiptianë. Ndërkohë që, pranë Shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, Shkodër, mësojnë nxënës romë dhe të maxhorancës.

Ndërkohë që, nga analizimi i të dhënave të tabelës së mësipërme, ku reflektohet informacioni i dërguar nga Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Liria” vihet re dominanca e nxënësve egjiptianë, të cilët për vitin arsimor 2018-2019 kapin shifrën 73 nxënës, të cilët mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër. Në vijim, rezulton se për të njëjtin vit shkollor, pranë kësaj shkolle mësojnë 32 nxënës romë dhe 24 nxënës që i përkasin maxhorancës. Sipas të dhënave të mësipërme, rezulton se për vitin shkollor 2018-2019, të gjitha klasat e kësaj shkolle, kanë në përbërje të tyre nxënës romë, egjiptianë dhe të maxhorancës, ku numri i nxënësve egjiptianë dhe romë mbizotëron me atë të maxhorancës. Për sa më sipër, rezulton se raporti ndërmjet nxënësve romë dhe egjiptianë me ata të maxhorancës është përafërsisht 4:1. Njëkohësisht, referuar të dhënave tabelore rezulton se edhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, për vitin shkollor 2018-2019, numri i nxënësve romë është më i madh se numri i nxënësve të maxhorancës, si dhe konstatohet se në klasën e I, V dhe VII ka vetëm nxënës romë.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton mospërputhje me të dhënat e raportuara fillimisht nga DAR Shkodër dhe nga drejtuesi i Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Një fakt i tillë krijon dëshmon për një mos organizimim dhe mos koordinim të mirë ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Duke iu referuar të dhënave të dërguara nga DAR Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. 1494, datë 26.10.2018¹⁵, situata e përbërjes komunitare në Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, për dy vitet e fundit shkollor, përbën një rast të pastër segregimi apo veçimi të nxënësve romë dhe egjiptianë. Por, edhe nëse mbështetemi në të dhënat e dërguara nga drejtuesi i Shkollës, sërisht dominanca e nxënësve të komunitetit rom dhe egjiptian pranë këtyre shkollave është mëse evidente.

¹⁵ Shkresa nr. 2404/1, datë 15.10.2018, e DAR Shkodër.

Në pikën 16, të Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit nr. 7, për Politikën e Përgjithshme të ECRI-t *“Mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial”*, miratuar në 13 dhjetor 2002 dhe amenduar ne 7 dhjetor 2017 parashikohet shprehimisht: *“Segregimi/veçimi është veprimi me të cilin personi (fizik ose juridik) veçon persona të tjerë mbi bazën e një prej shkaqeve të renditura, pa ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në përputhje me përkufizimin e sugjeruar të diskriminimit.”*

Segregimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim, qoftë i qëllimtë apo jo, është njohur nga disa instrumente ligjore ndërkombëtare si një formë diskriminimi¹⁶. Referuar studimeve dhe hulumtimeve të ndryshme të kryera nga organizata të ndryshme ndërkombëtare¹⁷, sikurse mbështetur edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së apo GJED, segregimi në arsim i fëmijëve romë dhe egjiptianë merr forma të ndryshme, të tilla si: vendosja e fëmijëve romë/egjiptianë në shkolla speciale për persona me aftësi të kufizuara mendore¹⁸, ndarja e nxënësve romë/egjiptianë në klasa të vetme brenda shkollave të zakonshme, që frekuentohen edhe nga nxënës të maxhorancës apo edhe mbajtjen e shkollave vetëm për romë të vendosura në geto/lagje/zona me përbërje kryesisht rome, ose të krijuara si rezultat i tërheqjes së jo-romëve nga këto shkolla.¹⁹ Segregimi ndodh dhe në mjediset e shkollave të zakonshme të arsimit publik, ku fëmijët romë mund të caktohen në klasa të veçanta, mund të ndalohen që të përdorin mjediset e përbashkëta sportive apo mensat.²⁰ Në disa vende, segregimi fillon që në arsimin parashkollor, përmes regjistrimit të fëmijëve romë në klasa të veçanta përgatitore që, në praktikë, nuk çon në përfshirjen e tyre në shkollat e zakonshme të arsimit fillor, por përbën fillimin drejt rrugës së arsimit të ndarë.²¹

Segregimi ose veçimi në fushën e arsimit është një realitet që ndeshet herë pas herë në institucionet arsimore në Shqipëri. Pasojat negative të tij prekin veçanërisht fëmijët romë dhe egjiptianë. Pavarësisht legjislacionit në fuqi dhe politikave kundër diskriminimit, praktikat segreguese shpesh herë përbëjnë një realitet të dukshëm. Segregimi në arsim është një nga

¹⁶ Referuar parashikimeve të Rekomandimit nr. 7, për Politikën e Përgjithshme të ECRI-t *“Mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial”*,

¹⁷ Factsheet “Roma and Travellers”, Council of Europe; Dhjetor 2018; ¹⁷Luftimi i segregimit shkollor në Europë, nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës: Qendrimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës (2017);

¹⁸ “D.H. e të tjerë kundër Republikës Çeke”, kërkesa nr. 57325/00, vendim gjyqësor i Dhomës së Madhe i datës 13/11/2007, paragrafi 18; “Horvath and Kiss v. Hungary”(ECHR).

¹⁹ Lavidia and others v. Greece, (Application no. 7973/10), Vendimi i GJEDNJ, datë 30.05.2013;;

²⁰ Shih raportet për: Portugalinë (2012), paragrafët 61 dhe 62; Rumaninë (2014), paragrafi 175; dhe Hungarinë (2014), paragrafët 105 dhe 106.

²¹ Shih Raportin e KE për Sllovakinë (2015), paragrafi 87.

format e diskriminimit dhe përbën shkelje të rëndë, të drejtave të fëmijëve në fjalë, për sa kohë që mundësitë e tyre për të mësuar dëmtohen seriozisht nga veçimi.

Paragjykimet e rrënjësura thellë dhe refuzimi ndaj pakicave etnike (veçanërisht ndaj komunitetit rom/egjiptian) kanë çuar në praktika përjashtimore, që shkojnë në segregim. Një shembull i kësaj dukurie është dhe ndarja e fëmijëve romë, nga nxënësit e tjerë, bazuar në argumentimin se kjo gjë parapëlqehet nga prindërit ose në paramendimet kulturore dhe veçantitë shoqërore. Vullneti apo parapëlqimi i prindërve romë dhe egjiptianë për t'i regjistruar fëmijët e tyre pranë Shkollës 9-vjeçare "Liria" ishte një fakt që u parashtrua edhe nga institucionet përgjegjëse, pasi edhe ligjërisht vullneti i prindit për regjistrimin e fëmijës në shkollë konsiderohej kryesor²². Por, pavarësisht sa më sipër, sikurse nënvizohet edhe në vendimin e dhënë nga GJEDNJ për çështjen "D.H. e të tjerë kundër Republikës Çeke", paragrafi 142, dakordësia e prindërve në asnjë rast nuk mund të shërbejë si justifikim për praktika diskriminuese.²³

Komisioneri gjykon se vullneti i prindërve është tepër i rëndësishëm lidhur me përzgjedhjen e institucionit arsimor, ku do të mësojnë fëmijët e tyre, por faktor vendimtar, në lidhje me vendimarrjen e prindërve për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollë, ku përqëndrimi i nxënësve romë dhe egjiptianë është shumë më i madh, sesa numri i nxënësve të maxhorancës, është mungesa e një procesi të rregullt informues të institucioneve përgjegjëse ndaj këtyre prindërve për t'i njohur ata me konceptin e segregimit apo veçimit, si dhe me pasojat e tij tek fëmijët e tyre.

Nëse prindërit romë dhe egjiptianë do të ishin pjesë e një procesi të tillë informues, i cili duhet të ishte gradual dhe i përshtatshëm për nivelin e tyre arsimor dhe kulturor, nëse ata do të njiheshin me pasojat e segregimit apo veçimit të fëmijëve të tyre, nga fëmijët e tjerë, si dhe nëse do të informoheshin mbi faktin se ata mund t'i regjistrojnë fëmijët e tyre edhe në shkollë të tjera që ndodheshin më larg vendbanimit të tyre, në lagjen "Liria", por transporti për këta fëmijë do të sigurohej falas nga DAR apo Bashkia Shkodër, vendimarrja e tyre mund të kishte qenë e ndryshme. Procesi informues mbi pasojat e segregimit ndaj prindërve romë dhe egjiptianë luan një rol tepër të rëndësishëm dhe një gjë e tillë theksohet edhe nga GJEDNJ në vendimin e dhënë për çështjen "D.H. e të tjerë kundër Republikës Çeke".

²² Në nenin 13, pika 2, të Urdhërit Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar" (i ndryshuar) parashikohet: "Në gjashtë ditët e para kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e parë të një shkolle publike vetëm nxënësit që i përkasin zonës së shkollës. Kur largesa e banesës së fëmijës nga dy shkollat publike është e diskutueshme, prindi zgjedh njërin nga të dyja shkollat. Në katër ditët pasuese kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënës që u përkasin shkollave të zonave të tjera. Regjistrime të veçanta pranohen deri ditën para fillimit të vitit shkollor."

²³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, "D.H. e të tjerë kundër Republikës Çeke", paragrafi 142.

Njëkohësisht, në mënyrë që të luftohet segregimi shkollor, zgjedhja e shkollës duhet të kontrollohet në mënyrë të kujdesëshme nga institucionet përgjegjëse. Komisioneri gjykon se duhet të vendosen rregulla të qarta lidhur me këtë proces dhe duhet të balancohet parimi i zgjedhjes së shkollës me synimin që të shqyrtohen dhe përmbushen të gjitha nevojat arsimore. Në parim, ky proces përfshin masa të tilla siç është ngushtimi i raportit të nxënësve nga grupet e paavantazuara, siç janë romët dhe egjiptianët, me nxënësit e tjerë²⁴ në shkolla të caktuara.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar një praktikë gjyqësore të gjerë lidhur me segregimin në fushën e arsimit, që prek veçanërisht fëmijët romë dhe egjiptianë. Në mënyrë të përsëritur, kjo Gjykatë ka konstatuar raste të shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) nga vendet anëtare për sa i takon të drejtës së këtyre fëmijëve për të mos u diskriminuar në lidhje me të drejtën e tyre për arsim.²⁵

Në çështjen Lavidia dhe të tjerët kundër Greqisë, GJEDNJ ka vendosur: *“Edhe në mungesë të një synimi për të diskriminuar nga ana e shtetit, një qëndrim i cili konsiston në arsimimin e fëmijëve romë në një shkollë shtetërore, që ndiqet ekskluzivisht nga fëmijët që i përkasin komunitetit rom dhe vendos mosmarrjen e masaev efektive kundër segregimit nuk do të konsiderohet objektivisht e justifikueshme nga një qëllim legjitim”*.

Në vijim të seancës dëgjimore, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Liria” depozitoi në cilësinë e provës pranë Komisionerit, shkresën nr. 606²⁶, *“Raportin mbi zhvillimin e takimeve me prindër në kuadër të ndërgjegjësimit komunitar mbi problematikën e segregimit në institucionet arsimore”*. Nëpërmjet këtij Raporti, Komisioneri bëhet me dije se drejtuesi i shkollës ka kryer 2 takime sensibilizuese me mësues, nxënës dhe prindër. Në takimin e parë, të realizuar në datën 04.09.2018, drejtuesi i shkollës thekson faktin se u diskutua mbi problematikën e segregimit dhe u paraqitën masat e marra nga ana e drejtorisë dhe bordit të shkollës, të cilat kanë në thelb hartimin e një plani gjithëpërfshirës, duke evidentuar mundësitë që ka secili nga aktorët në përmbushjen e objektivave të vendosura bashkarisht. Për sa më sipër, Komisioneri vë re mospërputhje të thënieve të drejtorit të shkollës gjatë seancës dëgjimore me Raportin e sipërpërmendur. Në seancë, drejtuesi i shkollës e ka përmendur takimin e në fjalë, por është shprehur se i ka informuar prindërit e fëmijëve se janë të lirë t’i regjistrojnë fëmijët e tyre në

²⁴ Shih Rekomandimin nr. 4, datë 11.09.2014, të KMD-së *“Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë”*;

²⁵ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Dokument informues për romët dhe endacakët” (i përditësuar në qershor 2017), që përmban informacion për një sërë rastesh ku konstatohen shkelje të nenit 14 (“Ndalimi i diskriminimit”) të Konventës, si dhe nenit 2 (“E drejta për arsim”) të Protokollit 1.

²⁶ Shkresa në fjalë nuk rezulton të ketë datë regjistrimi.

cilëndo shkollë, por jo të ketë dhënë informacion mbi segregimin e pasojat e tij. Mosdhënia e informacionit mbi konceptin e segregimit vinte si pasojë se edhe vetë drejtuesi i kësaj shkolle kishte marrë dijeni së fundmi mbi këtë koncept²⁷.

Për sa më sipër, Komisioneri thekson faktin se zbatimi i praktikave të segregimit, gjatë disa dhjetëvjeçarëve, sjell pasoja të dukshme dhe të rënda për arsimin e veçuar të fëmijëve²⁸. Segregimi shkollor është jo vetëm një praktikë që diskriminon fëmijët dhe cënon të drejtën e tyre për arsim në mënyrë të barabartë me të tjerët, por gjithashtu zvogëlon mundësitë e tyre për të përfituar aftësi thelbësore për jetën përmes kontaktit me të tjerët dhe shpeshherë, ky është hapi i parë i segregimit në jetë. Segregimi minon qartë mundësitë e ardhshme për punë dhe pagë për shumë fëmijë e të rinj. Për fëmijët romë dhe egjiptianë, segregimi mund të çojë gjithashtu drejt zvogëlimit të mundësive për të përftuar aftësi shoqërore dhe jetësore të rëndësishme, si pasojë e mungesës së ndërveprimit me fëmijë me prejardhje të ndryshme etnike ose kulturore.

Studimet e kryera tregojnë se segregimi shkollor ndikon negativisht, jo vetëm tek nxënësit romë dhe egjiptianë, por gjithashtu rrezikon të gjithë performancën e procesit arsimor. Për këtë arsye, ndalimi i segregimit shkollor është jo vetëm i domosdoshëm për të garantuar të drejtën për arsim dhe barazinë në sistemin arsimor, por gjithashtu është thelbësor për të përmirësuar efektshmërinë dhe performancën e sistemit arsimor në tërësi. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) ka paralajmëruar për pasojat që ka segregimi shkollor tek arrijtjet arsimore²⁹. Vendet me indeksin më të lartë të përfshirjes sociale në shkolla (shkollat me përbërje më të lartë heterogjene të nxënësve nga pikëpamja kulturore dhe sociale) janë gjithashtu ato që kanë dalë më mirë në testin e matematikës të anketimit PISA 2012.³⁰ Këto rezultate i atribuohen “efektit të bashkëmoshatarëve”, më saktë, rezultatet pozitive burojnë nga fakti se nxënësit, që kanë vështirësi në të mësuar, përfitojnë nga të qenurit në të njëjtën hapësirë arsimore me bashkëmoshatarët më të përparuar.

Kërkimet në këtë fushë theksojnë se përbërja heterogjene e klasave në institucionet arsimore është pozitive, veçanërisht për nxënësit më të paavantazhuar, ndërsa “humbja” e vëzhguar, që

²⁷ Shih përmbajtjen e seancës dëgjimore të zhvilluar nga KMD mbi këtë çështje ex-officio.

²⁸ Luftimi i segregimit shkollor në Europë, nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës: Qendrimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës (2017), f. 14;

²⁹ OBEZH (2012), “Barazia dhe cilësia në arsim: mbështetja e nxënësve dhe shkollave të paavantazuara”, Botim i OBEZH-it, Paris;

³⁰ OBEZH (2013), “Rezultatet e PISA 2012: cilësi përmes barazisë – dhënia çdo nxënësi e mundësisë për t’ia dalë (vëllimi II)”, PISA, Botim i OBEZH-it, Paris;

buron nga përbërja heterogjene, për nxënësit më të avantazhuar është e pakët.³¹ Anasjelltas, përqendrimi i madh në të njëjtën klasë i nxënësve, që kanë vështirësi për të mësuar, ul cilësinë arsimore dhe pritshmërinë e mësuesve sa i takon potencialit për rezultate në mësim të nxënësve të tyre. Veçimi i grupeve të pakicave, siç janë romët, të regjistruar rishtas në sistemin arsimor, dëmton integrimin shoqëror të këtyre nxënësve dhe dobëson lidhjet që mbajnë kohezionin social. Mungesa e kontakteve ndërkulturore ka gjasa të rezultojë në një tolerancë më të pakët ndaj shumëllojshmërisë, mungesë respekti për dallimet fetare dhe kulturore dhe mund të nxisë qëndrimet raciste, diskriminimin dhe përjashtimin mes të rinjve.

Përveç më sipër, segregimi shton rastet e braktisjes së shkollës. Referuar informacionit të përcjellë nga DAR Shkodër rezulton se gjatë vitit shkollor 2018-2019, në shkollat e mesme të qytetit të Shkodrës janë regjistruar gjithësej 6 nxënës romë dhe 11 nxënës egjiptianë. Ky fakt dëshmon për një braktisje në masë të shkollës nga ana e tyre.

Në disa vende europiane, fëmijët romë shpesh regjistrohen në shkolla vetëm për romë ose në shkolla me një përqendrim shpërpjesëtimor të fëmijëve romë, ku, në shumicën e rasteve, ata marrin një arsim më pak kërkuar dhe shpesh nën standardet e kërkuara. Nga një anketim i zhvilluar në vitin 2016 nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, në nëntë Vende Anëtare të BE-së, rezulton se 33% e fëmijëve romë ndiqnin shkolla, ku pjesa më e madhe e nxënësve i përkiste këtij komuniteti, dhe 13% ndiqnin shkollat vetëm për romë.³² Në këtë situatë, Komisioni Evropian filloi procedimin për shkelje ndaj tre Vendeve Anëtare të Bashkimit Evropian, për sa i takon ndalimit të diskriminimit në fushën e arsimit, të përcaktuar në Direktivën për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht racës ose përkatësisë etnike (Direktiva e Këshillit 2000/43/KE).³³

Në kontekstin e sipërpërmendur, vlen të theksojmë faktin se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet shkresës nr. 757, datë 11.09.2014, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka dhënë disa rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin, në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin e vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar.

³¹ Luftimi i segregimit shkollor në Europë, nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës: Qendrimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës (2017);

³² Agjencia për të Drejtat Themelore të BE-së, “Anketimi i Dytë për Pakicat dhe Diskriminimin në Bashkimin Evropian (SDMDBE II), Romët – fakte të përzgjedhura” (2017). Në këtë anketim janë përfshirë nëntë shtete: Bullgaria, Republika Çeke, Kroacia, Greqia, Hungaria, Portugalia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

³³ Republika Çeke (2014), Sllovakia (2015) dhe Hungaria (2016).

Në Rekomandimin nr. 4, datë 11.09.2014, të Komisionerit “Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë”, ndër të tjera parashikohet:

“.....DAR/ZA duhet të ndjekin në vazhdimësi frekuentimin e shkollës nga ana e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe ndryshimin e raportit mes nxënësve që i përkasin këtyre komuniteteve dhe atyre që nuk i përkasin, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian, për të parandaluar në këtë mënyrë, krijimin e zonave apo shkollave, të cilat frekuentohen vetëm nga fëmijë të komunitetit egjiptian. Një kujdes i posaçëm duhet të tregohet gjatë krijimit të klasave të para apo në rastet e ristrukturimit të klasave, për të shmangur veçimin apo segregimin e fëmijëve romë në klasa të caktuara, duke krijuar në këtë mënyrë klasa vetëm me fëmijë romë”.

Realisht, ky rekomandim i Komisionerit nuk është zbatuar nga institucionet kompetente. Njohja dhe pranimi i situatës së segregimit dhe veçimit të nxënësve romë në shkollën 9-vjeçare “Liria Shkodër”, duhet të shoqërohet me një politikë efektive dhe sistematike për të luftuar veçimin dhe segregimin e fëmijëve rom e egjiptianë në arsim. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se fëmijët romë dhe egjiptianë në këtë shkollë janë kufizuar dhe ndaluar nga gëzimi i të drejtës për të mësuar, studiuar dhe bashkëjetuar në një shoqëri multikulturore dhe gjithëpërfshirëse.

Referuar nenit 30, pika 3 dhe 4³⁴, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) është përgjegjësi ligjore e DAR Shkodër, ndalimi apo shmangia e kësaj situate segregimi në këtë shkollë, duke ndryshuar raportin e nxënësve rom e egjiptianë me ata të maxhorancës. Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i DAR Shkodër sqaroi se shkolla të tjera të afërta me shkollën 9-vjeçare “Liria” janë shkollat 9- vjeçare “Ali Laçej” dhe “Ndre Mjeda”, Shkodër, distanca e të cilave me Lagjen Liria është mbi 2 km. Në këto kushte, mund të veprojnë parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimore që punojnë dhe

³⁴Në nenin 30, pika 3 dhe 4, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikohet:

“3. Njësia Arsimore Vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj.

4. Njësia arsimore vendore:

a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;

b) mbështet institucionet arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor;

c) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore si dhe për rastet e braktisjes së shkollës;

ç) siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore, sipas formulës “për nxënës”;

d) përdor fondin e vecantë të buxhetit vjetor për shpërblimin e punonjësve të institucioneve arsimore publike me artitje të shquara. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”(i ndryshuar), i cili siguron transport falas për largësi mbi 2 km, të vendbanimit me shkollën e nxënësit.

Në të njëjtin kontekst, vlen të theksohet edhe Vendimi nr. 176, datë 16.12.2015, i KMD-së, i cili është dhënë për një rast analog, me atë të Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër, ku Komisioneri konstatoi diskriminim në formën e segregimit të nxënësve romë të Shkollës 9-vjeçare “Abdyl Avdia”, në fshatin Moravë, Berat.

Shteti ka detyrimin pozitiv, të sanksionuar fuqishëm në legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, për të ndaluar segregimin në arsim. Kjo gjë mund të arrihet përmes ndërthurjes së masave të forta antidiskriminuese, përfshirë masat ligjore, me politika që promovojnë sisteme arsimore gjithëpërfshirëse. Sipas përcaktimit të UNESCO-s,³⁵ arsimi gjithëpërfshirës është: *“...një proces që trajton dhe i përgjigjet shumëllojshmërisë së nevojave të të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në procesin arsimor dhe njohjes së kulturës dhe komuniteteve, si dhe zvogëlimit dhe eliminimit të përjashtimit në dhe nga arsimi”*.

Ky është një parim që përcakton përgjegjësinë (detyrimin pozitiv) e shteteve për të arsimuar të gjithë fëmijët, pa asnjë lloj diskriminimi, brenda sistemit të shkollave të zakonshme të arsimit publik. Si i tillë, arsimi gjithëpërfshirës përmbledh luftën kundër modeleve të segregimit që prekin fëmijë të caktuar në veçanti, por gjithashtu shkon përtej kësaj. Ai përbën një qasje që e konsideron segregimin si një dukuri negative që pengon të drejtën e të gjithë fëmijëve për arsim. Ai refuzon nocionin “të ndarë, por të barabartë” dhe synon që t’i bëjë shoqëritë të hapura për të shkëmbyer informacion dhe për të mësuar nga shumëllojshmëria e tyre.³⁶

Sikurse rekomandohet nga Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në Rekomandimin nr. 7 të Politikës së Përgjithshme të tij për politikat kombëtare për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial³⁷, segregimi konsiderohet qartë si formë diskriminimi ndaj grupeve vunerabël, e sidomos romëve dhe egjiptianëve. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nxënësit romë dhe egjiptianë të Shkollës 9-vjeçare “Liria” bashkë me shtesat e saj, diskriminohen në formën e segregimit, nga ana e DAR Shkodër.

³⁵ UNESCO (2009), “Udhëzime lidhur me politikën për përfshirjen në arsim”, UNESCO, Paris.

³⁶Luftimi i segregimit shkollor në Europë, nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës: Qendrimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Europës (2017);

³⁷Rekomandimi Nr. 7, i ECRI-t, mbi Politikën së Përgjithshme për politikën kombëtare për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial, paragrafi 6. Gjithashtu, shih raportet e KERI-t për çdo vend, të cilët përmbajnë rekomandime të dobishme se si të ndërtohet një kuadër ligjor gjithëpërfshirës kundër diskriminimit.

B. Referuar informacionit të dërguar nga ERRC, rezulton se njëri prej pretendimeve kryesore për segregimin e nxënësve romë dhe egjiptiane pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, konsistonte në faktin se një pjesë e nxënësve të kësaj shkolle, mësonin pranë Kuvendit të Fretërve Kapuçinë, në Fshatin e Paqes, Shkodër. Në seancën dëgjimore, të zhvilluar pranë KMD-së, drejtori i shkollës informoi, se tashmë këta nxënës nuk mësojnë më pranë Fshatit të Paqes, por mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Ndër të tjera, ai sqaroi se ky ishte një transferim i përkohshëm i tyre, pasi infrastruktura rrugore jo e mirë (ura) nuk e mundësonte që këta nxënës, të vinin çdo ditë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Për këtë arsye, ata përkohësisht kishin ndjekur mësimin pranë Fshatit të Paqes. Aktualisht, në kushtet e një infrastrukture të përmirësuar, nxënësit vazhdojnë mësimin pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”. Duke qenë se kjo çështje është zgjidhur përgjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri e konsideron si një qëllim të arritur.

C. Një tjetër problematikë, së cilës Komisioneri i ka kushtuar vëmendje të veçantë, është ajo e sistemit nëpër shkolla të fëmijëve romë të ardhur nga qytete të tjera dhe shpërndarjes jo të njëtrajtëshme të tyre në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Shkodrës.

Sipas informacionit të përcjellë nga DAR Shkodër rezulton se DAR Shkodër në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, në këtë vit shkollor ka bërë të mundur regjistrimin në shkollë të 126 nxënësve në situatë rruge në 12 shkolla, si më poshtë:

- 1 nxënës pranë Shkollës së Mesme të Bashkuar “Adem Haxhia”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 24 nxënës pranë shkollës vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem;
- 1 nxënës pranë shkollës vartëse “Domen”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 2 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Dragoç”, Njësia Administrative Postribë, Bashkia Shkodër;
- 9 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Edit Durham” Shkodër;
- 8 nxënës pranë shkollës 9-vjeçare “Isa Jakupi”, Dobrac, Njësia Administrative Rrethina;
- 18 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Martin Camaj”, Bashkia Shkodër;
- 17 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ndoc Mazi”, Shkodër;
- 1 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, Shkodër;
- 3 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Ruzhdi Daca”, Shkodër;
- 41 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “Salo Halili”, Shkodër;
- 1 nxënës pranë Shkollës 9-vjeçare “3 Dhjetori”, Shkodër.

DAR Shkodër thekson faktin se shpërndarja e mësipërme është kryer në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit nr. 17, datë 09.05.2018 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”, si dhe në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet MAS, MB, MPCSSHB, MSH, Nr. 1613, datë 04.09.2013, duke siguruar për nxënësit romë e egjiptianë mësim integruar dhe mësim mbështetës, nëpërmjet zbatimit të planeve individuale që vetë shkollat do të implementojnë për këta nxënës.

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet përqëndrim më i madh i nxënësve romë pranë Shkollës 9-vjeçare “Salo Halili”, Shkodër, ku janë sistemuar rreth 41 nxënës, ndërkohë që sikurse është përmendur nga ERRC, pranë shkollës së mësipërme, ndodhet Shkolla 9-vjeçare “Ndre Mjeda”, pranë së cilës është sistemuar vetëm një nxënës rom. Përqëndrim të madh të nxënësve romë, krahasuar me shkollat e tjera, ka edhe Shkolla “Isuf Tabaku”, ku mësojnë 26 nxënës romë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon dhe rekomandon se duhet të ketë një shpërndarje sa më njëtrajtëshe të nxënësve romë në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Shkodrës, në mënyrë që të mos krijohen përqëndrime të mëdha të tyre në shkolla të caktuara dhe këta nxënës të integrohen në mënyrë sa më normale me nxënësit e tjerë.

D. Një problematikë tjetër e evidentuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje ex-officio është edhe çështja e sigurimit të transportit falas për nxënësit romë dhe egjiptianë dhe kriterëve që duhen plotësuar për të përfiturar këtë lehtësi.

Referuar legjisllacionit në fuqi rezulton se transporti falas i nxënësve për në shkollë kryhet vetëm në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” (i ndryshuar). Në bazë të këtij vendimi, kur largësia e banesës së nxënësit nga shkolla është më pak se dy kilometra, nuk mund të mundësohet transporti me fonde publike. Në pikën 1, gërma b), të VKM-së së sipërpërmendur parashikohet shprehimisht: “1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:.....b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimorë publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimorë publike më të afërta (shkollë/kopsht); Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimorë publike (shkollë/kopsht).”

Në bazë të pikës 1, gërmës ç), të kësaj VKM, nga parashikimi i mësipërm përjashtohen vetëm nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.

Mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore, rregullimi i çështjes së transportit është kompetencë e DAR Shkodër, i cili zbaton parashikimin e VKM-së së sipërpërmendur dhe siguron transport për fëmijët romë e egjiptianë, të cilët frekuentojnë shkolla, vendndodhja e së cilave është mbi 2 km, nga vendbanimi i nxënësve. Por, në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se edhe Bashkia Shkodër ka arritur të sigurojë transport falas për fëmijët romë dhe egjiptianë, sidomos për ata që frekuentojnë qendrat komunitare.

Në Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020), miratuar me Vendimin nr. 1072, datë 23.12.2015, e Këshillit të Ministrave, në Fushën e politikës *“Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor”* parashikohet qëllimi strategjik: *“Arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.”* Në pikën 1.10, të këtij qëllimi strategjik përcaktohet: *“Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopështe i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkollat/kopshtet larg mbi 2 km dhe që kalojnë vijën ndarëse të Bashkisë”*.

Në pikën 1.11, të të njëjtit qëllim strategjik përcaktohet: *“Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopështe i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkollat/kopshtet larg (edhe nën 2 km) për arsye sigurie të justifikuar”*.

Për sa më sipër, transporti falas nën 2 km për fëmijët romë dhe egjiptianë mund të kryhet vetëm për *“arsye sigurie të justifikuar”*, por pa sqaruar dhe pa dhënë interpretimin përkatës, se cilat do të konsiderohen të tilla. Njëkohësisht, një parashikim i tillë nuk është pjesë e parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.07.2015 *“Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”*(i ndryshuar).

Komisioneri gjykon se, nëse kërkohet parandalimi dhe evitimi i situatave segreguese në shkolla, si dhe nëse duhet të krijohet një raport sa më i pranueshëm, ndërmjet numrit të nxënësve romë dhe egjiptianë me numrin e nxënësve të maxhorancës, duhen krijuar e ofruar mundësitë optimale dhe kushtet e duhura, për të arritur këtë qëllim. Komisioneri i jep përparësi faktit të ndalimit të segregimit dhe për ta arritur këtë qëllim, duhen përdorur të gjitha mjetet dhe burimet e nevojshme, që janë në dispozicion. Nëse, pranë vendbanimit të fëmijëve romë do të ndodheshin 3 shkolla në largësi të ndryshme, nën 2 km, fëmijët romë dhe egjiptianë do të frekuentonin shkollën më të afërt, duke krijuar përqëndrim të madh, të tyre pranë kësaj shkollë, ndërkohë që

do të frekuentonin pak ose aspak 2 shkollat e tjera. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se do të favorizohej segregimi i këtyre nxënësve dhe përqendrimi i tyre në shkolla të caktuara. Për të shmangur dhe parandaluar segregimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve, Komisioneri rekomandon, që fëmijëve romë dhe egjiptianë t'u sigurohet transport falas edhe kur largësia ndërmjet shkollës dhe vendbanimit të tyre është nën 2 km.

Në lidhje me situatën specifike në Lagjen "Liria", Komisioneri është i informuar se kjo zonë ka një përqendrim të madh të komunitetit egjiptian, prej shumë kohësh i stabilizuar në qytetin e Shkodrës dhe komunitetit rom, kryesisht të ardhur nga zonat përreth. Nga ana tjetër në po të njëjtën zonë ka dhe një përqendrim të konsiderueshëm të mazhorancës, por, pavarësisht kësaj numri i nxënësve të mazhorancës në raport me ato të komuniteteve romë dhe egjiptiane është shumë herë më i vogël. Ky fakt krijon bindjen se prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla të tjera përreth, ku ka përqendrim më të vogël të komunitetit rom dhe egjiptian.

Me qëllim që kjo situatë të ndreqet, duhet që DAR Shkodër të zbatojë rigorozisht kriterin e vendosur në Dispozitat Normative, sipas të cilit nxënësit regjistrohen në shkollën që ndodhet në zonën e tyre të banimit. Duke implementuar këto dy dispozita, garantimin e transportit dhe regjistrimin e fëmijëve sipas kriterit të zonës së shkollës DAR Shkodër, mund të ndreqë situatën segreguese të krijuar në shkollën Liria dhe shkollën vartëse të saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 3, pika 3, nenin 7, pika 1, nenet 17-19, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma c), pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, si dhe nenin 33, pikat 10, 11 e 13, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", nenin 30, pika 3 dhe 4, të ligjit 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", pikën 16, të Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit nr. 7, për Politikën e Përgjithshme të ECRI-t "*Mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racia*", (miratuar në 13 dhjetor 2002 dhe amenduar ne 7 dhjetor 2017), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.07.2015 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*" (i ndryshuar). Urdhërin nr. 343, datë 19.8.2013, e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "*Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar*" (i ndryshuar), si dhe Rekomandimin nr. 4, datë 11.09.2014, të Komisionerit "*Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë*"

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e segregimit, nga ana e DAR Shkodër, për shkak të “racës”, së nxënësve romë dhe egjiptanë, që mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, Shkodër.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga DAR Shkodër, për shmangien e situatës së segregimit, duke zbatuar Dispozitat Normative, në lidhje me zbatimin e kriterit të regjistrimit të nxënësve sipas zonës së shkollës.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga ana e DAR Shkodër, drejtuesit e shkollave në këtë qark, nën mbështetjen dhe asistencën e ERRRC-së dhe organizatave të tjera, për kryerjen procesit informues me familjet rome dhe egjiptiane, mbi segregimin dhe pasojat e tij në arsim.
4. DAR Shkodër të marrë masat e nevojshme, për vitin e ardhshëm shkollor, për një shpërndarje sa më të njëtrajtëshme të nxënësve romë dhe egjiptianë në shkollat e qarkut Shkodër.
5. Rekomandohet që Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të kryejë propozimet përkatëse, për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 29.07.2015 *“Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” (i ndryshuar)*, duke përfshirë transport falas për nxënësit romë dhe egjiptianë, edhe për largësitë nën 2 km.
6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DAR Shkodër dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

8. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – arsim
Shkaku- raca